11 kisha gabim. E pranoj gabimin. Faleminderit.

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Po, është prova materiale  
13 P759.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Sekretar.

15 Dhe i nderuar Gjykatës, nuk kam më pyetje të tjera.

16 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Nuk kemi pyetje në këto momente.

17 Z. TULLY: [Përkthim] Edhe unë kam disa pyetje, por ndoshta  
18 edhe 15 minuta kohë duhen, për vetëm disa sqarime.

19 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
20 vazhdoni.

21 Nëse seancë publike apo private?

22 Z. TULLY: [Përkthim] Në seancë publike jemi në rregull.

23 Pyetje të palës tjetër nga z. Tully:

24 Z. TULLY: [Përkthim]

25 PY. Atëherë, i nderuar Dëshmitar. Unë quhem z. Tully dhe



1 ndoshta ju mund të sqaroni diçka. Ndoshta nuk thatë diçka  
2 gabim ose që nuk është mbajtur diçka gabim. A i thatë z.  
3 Kehoe, dhe është në transkript në Pjesën 2, në rreshtin e  
4 parë, që jo vetëm që ishin pushka ose arma dhe pistoleta në  
5 traktor që nuk ishin të miat, por as nuk e dija që ishin në  
6 traktor. A është kjo dëshmia juaj? Pra, ju nuk e dinit që  
7 gjendeshin aty këto?

8 PË. Po, është e saktë. Nuk e dija sepse po të kisha shkuar në  
9 front, nuk do të shkoja me pistoletë dhe me një armë gjahu. Në  
10 të njëjtën kohë për ta sqaruar pyetjen të cilën ju po më bëni,  
11 dy oficerë ushtarakë në fshatin Movljane, asnjë nga komshinjtë  
12 e mi shqiptarë etnikë nuk janë vrarë edhe pse i vunë në rresht  
13 rreth 40 prej tyre prej tyre për t'i qëlluar.

14 Vojislav Jeftiq, babai i kushëririt tim, doli në fakt që  
15 t'i shpëtonte të gjithë këta shqiptarë dhe i shpëtoi ata.

16 PY. Në fakt pyetjet që do t'ju bëj unë kanë të bëjnë vetëm me  
17 njohuritë tuaja për armët në traktor. Për këto do t'ju bëj  
18 pyetje.

19 Pra, dini gjë nëse për shembull, edhe personi tjetër  
20 dinte, Krsta, dinte nëse këto armë ishin në traktor? Dini gjë  
21 ju?

22 PË. Vërtetë që nuk mund ta them, sepse nuk e di vërtetë.

23 PY. Në rregull. Pra, axha juaj që e ka këtë traktor, ai është  
24 bujk, fermer, prandaj e kishte traktorin, apo jo? Sa të madhe  
25 e ka fermën ai? E kishte të madhe, të vogël?

1 PË. Nuk kishte fermë të madhe, përveç shtëpisë edhe një copë  
2 tokë. Kishte punuar goxha në Zvicër dhe kur humbi dëgjimin u  
3 kthye në fshatin e Reçanit si invalid.

4 PY. Pra, nuk ishte fermë e madhe, kështu që edhe traktorin nuk  
5 duhet ta kishte të madh, për këtë fermë. Pra, ishte një  
6 traktor i vogël?

7 PË. Po, ishte traktor i vogël i cili kishte -- ishte 14 kuaj  
8 fuqi.

9 PY. Dhe ishte me kabinë të mbyllur për sa i përket ulëses së  
10 shoferit, apo ishte e hapur?

11 PË. Traktori ishte tërësisht i hapur me një kuti të drunjtë  
12 pas për sa i përket të gjithë mjeteve, pajisjeve. Po vetë  
13 traktori, ose kishte të gjithë instrumentet e duhura.

14 PY. Në rregull. Pra, arma që u mor nga traktori ishte një armë  
15 gjahu. Pra, kjo ju nuk e di sa dini për armët, po do të --  
16 meqenëse keni shërbyer në ushtri, kjo gjithsesi duhet të  
17 kishte një pjesë fikse prej druri, apo jo? Se nuk është një  
18 armë normale ose pushkë normale me të cilën gjuhet, apo jo?

19 PË. Po, sigurisht.

20 PY. Që do të thotë që bëhet fjalë për një send rreth 300 apo  
21 350 cm ose një deri në një metër e gjysëm sepse kjo është  
22 gjatësia kryesisht e një arme gjahu. Mund ta thoni këtë, po  
23 apo jo?

24 PË. Në fakt që të përpiqem ta them shkurtimisht arma ishte në  
25 kuti, në këtë kutinë sepse e pashë kur e nxorën atë, ishte në

1 kutinë e pajisjeve.

2 PY. Nuk e keni përmendur më përpara kutinë e pajisjeve,

3 Dëshmitar, apo jo?

4 PY. Nuk e përmenda as pushkën më duket.

5 PY. Nuk e përmendët pushkën më përpara, këtë po thoni në

6 dëshminë tuaj?

7 PË. Jo pushkën sepse nuk e dija që pushka ishte e pranishme

8 apo se çfarë kishte brenda kësaj kutie.

9 PY. Dëshmitar, pra traktori ishte i hapur. Dhe a jeni dakord  
10 me mua tani në këtë moment që në fakt pistoletat, apo pushkët  
11 ishin mjaft të çmueshme si objekte, si sende për t'i patur në  
12 1998-n me konfliktin që po ndodhte rreth e rrotull?

13 PË. Jo, nuk është se ishin të çmueshme, sepse të gjithë i  
14 kishin, madje të rinjtë edhe të moshuarit, të gjithë ata që  
15 donin të kishin armë. Kushdo që donte mund ta kishte këtë.

16 PY. Ndoshta nuk përdora unë fjalën e duhur, jo të çmuara por  
17 të dobishme, sepse me pistoletën sigurisht të duhet për t'u  
18 mbrojtur jo për të dalë për gjah, apo jo?

19 PË. Më lejoni që të përpigëm që ta shpjegon në këtë formë. Në  
20 vitet 1990, ne të gjithë e dimë që filluan luftra në ish-  
21 Jugosllavinë, pra në Jugosllavinë e atëhershme dhe armët i  
22 mbanin të gjithë sepse kjo ishte dëshira e tyre. Pra, se si do  
23 të ishte që të mbaje armë se unë e di ose e mbaje për  
24 vetëmbrojtje, por nuk di si ta formuloj fjalën. Ishte edhe  
25 çështje krenarie që të kishe armë me vete sepse ne nuk po

1 përpiqeshim që t'i largoheshim njëri-tjetrit se ne uleshim  
2 edhe shoqëroheshim me shqiptarët në të njëjta kafene. Ne  
3 luanim bilardo, nuk kishim asnjë arsye në çfarëdolloj momenti  
4 që ne të mbanim armë sepse ishin të tjerët.  
5 PY. Në fakt, në rast se i mbron -- se i mban për mbrojtje ose  
6 për krenari pra, interesi juaj do të ishte që t'i kishit me  
7 vete ose afër vetes, jo t'i linit, për shembull, në një  
8 traktor që është i hapur fare, pa kabinë të mbyllur. Do t'i  
9 mbaje brenda shtëpisë..  
10 PË. Më besoni që si për serbët ashtu edhe për shqiptarët i  
11 kishin armët në shtëpi dhe e dinin se çfarë kishin të tjerët,  
12 çfarë armësh kishin të tjerët në shtëpi. Pra, serbët dinin  
13 çfarë armësh kishin shqiptarët, shqiptarët e dinin çfarë  
14 armësh kishin serbët, nuk ishte ndonjë gjë e re. Ndoshta  
15 kështu ju duket juve tani, por në fakt në atë kohë ne dinim  
16 për njëri-tjetrin se kush në posedim çfarë lloj armësh.  
17 Dhe në disa raste policia e atëhershme serbe vinte për  
18 shembull dhe i pyeste komshinjtë tanë shqiptarë për armë dhe  
19 ne ndërhyrim dhe nuk i lejonim që ata t'i keqtrajtonin ata për  
20 ato armë se nuk është se ishin të vlefshme fare.  
21 PY. E kuptoj, e kuptoj Dëshmitar. Por ajo që po përpiqem të  
22 them që ju kishit këto armë që ishin të vlefshme që ju e thatë  
23 që ishin për krenari, ju duheshin për mbrojtje, pra nuk është  
24 se do t'i linit në një kuti për pajisje në traktor por  
25 mbaheshin në shtëpi, kështu që xhaxhai juaj duhet t'i ketë

1 vënë në traktor atë mëngjes, kur hypët edhe ju në traktor.

2 Këtë po përpiqem të them.

3 PË. Jo. Armët ishin të djalit të tij, arma e gjahut, sepse i  
4 biri ishte gjahtar. Ndoshta kishin dalë për gjueti më përpara,  
5 për shembull, dy javë apo një muaj më parë. Pra, ishte aty dhe  
6 gjithashtu ai kishte edhe një dritë që e kishte fiksuar tek  
7 traktori dhe së bashku me shqiptarët shkonin, për shembull,  
8 për gjah qoftë për lepuj, qoftë për derra të egër.

9 PY. E kuptoj. Po sa e rëndësishme ishte që këto armë t'i  
10 kishit të arritshme në moment në rast se do të duheshin, pra  
11 jo thjeshtë armë gjahu, dhe këto ishin edhe fjalët tuaja,  
12 sepse ju thatë që i mbanim afër, dhe tani po thoshit që  
13 thjesht duhet t'i kishin lënë në traktor. Pra, ju thatë që i  
14 kishin lënë në traktor pas një udhëtimi ose dalje për gjah,  
15 por këtë s'e kishit thënë ndonjëherë më parë.

16 PË. Po sa e rrezikshme është arma e gjahut, mund të ma  
17 shpjegoni.

18 PY. Po pistoleta?

19 PË. Cila pistoletë, për cilën e keni fjalën?

20 PY. Se varet kush e merr në dorë atë, pistoletën. Sepse ju po  
21 thoni që kishte njerëz që vinin për t'jua marrë armët. Pra,  
22 edhe rreziku ekzistonte që të binin në duart e personave të  
23 gabuar, kështu që s'kishit pse t'i linin jashtë, a nuk është e  
24 saktë kjo?

25 PË. Më lejoni t'ju them diçka. Mund ta interpretoni ose ta

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 110

1 karakterizoni si të dëshironi, po unë e di me siguri sa e  
2 rrezikshme ishte dhe çfarë mund të kishte ndodhur ose çfarë  
3 dinim ne për njëri-tjetrin. Për asnjë moment nuk u kemi  
4 shkaktuar frikë apo rrezik të tjerëve me ato armë.  
5 PY. Dhe fakti që ishit tre meshkuj të rritur brenda këtij  
6 traktori, ku tamam ishte kjo kutia për pajisjet e ndryshme që  
7 s'e keni përmendur deri tani? Ku ishte tamam në traktor  
8 saktësisht? Pra, që ju thatë që është një kuti pajisjesh në të  
9 cilën ishte edhe pushka edhe pistoleta.

10 PË. Në pjesën e -- në rimorkio.

11 PY. Dëshmitar --

12 Z. TULLY: [Përkthim] Sekretar i seancës, nëse mund të  
13 vendosim në ekran provën materiale P756.1 dhe dëshiroj që të  
14 shkojmë në faqen 17 të saj, ju lutem.

15 PY. Dëshiroj që të shikojmë me kujdes dy pjesë të ndryshme të  
16 kësaj faqe, se ju e përmendët se në këtë kuti pajisjesh në të  
17 cilën ishin pushka dhe pistoleta, a ishin në traktor apo në  
18 rimorkio nga e cila e morën UÇK-ja. A është e saktë kjo pra që  
19 thatë, që ishin në rimorkio që e tërhiqte traktori?

20 PË. Po, sigurisht, po tek rimorkioja tek pjesa e pasme.

21 PY. Okej, atëherë dëshiroj që të lexoni lart nga rreshtat 1  
22 deri në 5 kur ju thoni që "U afrua Sokol Kabashi. Erdhi dhe  
23 konfiskoi pistoletën. E morën dhe ja dhanë një grupi, atyre të  
24 15-ve. Nuk e mbaj mend se kush erdhi dhe e mori pushkën".

25 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po përdorni

1 fjalën "traktor" apo "rimorkio".

2 Z. TULLY: [Përkthim] Në fakt po përdor fjalën "traktor",  
3 pra sinonimi, një fjalë në anglisht që është sinonimi për  
4 traktor. Dhe do t'jua shpjegoj edhe me shembull në një moment.

5 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk keni parë  
6 ndonjë gjë të tillë në Kosovë ma merr mendja?

7 Z. TULLY: [Përkthim] Në rregull, i nderuar Kryegjykatës.  
8 Por do të flas pikërisht për dallimin ndërmjet tyre.

9 PY. Atëherë shkojmë tek rreshti 15.

10 "Pra, njëri prej tyre u ul në plug dhe u ul tek rimorkjoja  
11 e plugut ..."

12 PËRKTHYESI: Na duhet faqja në serbisht.

13 Z. TULLY: [Përkthim] "... Na vendosën tek rimorkioja e  
14 plugut ...".

15 Pra kur po flisnim për këtë gjë, ju thatë që e morën  
16 direkt nga plugu, ndërsa ju thoni që kur u vendosët në  
17 rimorkio, pra, po bëni në fakt dallimin ndërmjet këtyre dy  
18 gjërave. Dhe në këtë faqe thuhet, në dëshminë që i keni dhënë  
19 ZPS-së, që ajo pushkë dhe ajo pistoletë dolën nga ai vend ku  
20 ishit ulur ju tek plugu, në traktor pra. Dhe ju sot po e  
21 ndryshoni dëshminë tuaj, Dëshmitar.

22 PË. A e dini sa e madhe është rimorkioja e një plugu? Së pari,  
23 rimorkioja është për afërsisht --

24 PY. [Nuk ka përkthim]

25 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim]

1 DËSHMITARI: [Përkthim] Rimorkioja e plugut mund të mbajë  
2 deri në 15 vetë, pra për t'u transportuar dhe kur personi që  
3 në fakt po përdor plugun ka mjaft hapësirë për të tre ne, por  
4 edhe për këtë kutinë e pajisjeve dhe madje në plug mund të  
5 kishin qenë katër apo pesë apo gjashtë prej nesh.

6 Z. TULLY: [Përkthim]

7 PY. Pra, Dëshmitar, ju po bëni dallimin tani ndërmjet plugut  
8 dhe rimorkios së plugut, apo jo?

9 PË. Po, ky është dallimi. Pra kemi një plug dhe plugu ka  
10 rimorkio. Ju kërkoj ndjesë. Ndoshta mund të bëj edhe një  
11 vizatim të këtij plugu për t'ju treguar se si ngjan se si  
12 duket. Dhe mund t'jua sqaroj pastaj në hollësi.

13 PY. Jo, Dëshmitar. Në rregull.

14 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully,  
15 ndoshta duhet t'ia thoni dëshmitarit çfarë dëshironi të thoni  
16 që ai ta kuptojë se pse me ç'kuptoj unë edhe ne nuk po e  
17 kuptojmë në fakt këtu në panel.

18 Z. TULLY: [Përkthim] Po, patjetër.

19 PY. Atëherë ajo që po them unë është që kur ju i dhatë  
20 dëshminë tuaj ZPS-së thatë që na e morën pra, pushkën dhe  
21 pistoletën sot nga traktori, në të cilin ishim ulur. Ndërsa ju  
22 e keni ndryshuar dëshminë sot duke thënë që këto ishin brenda  
23 një kutie pajisje në rimorkio dhe që ju nuk mund të kishit  
24 qenë ulur në traktor dhe nuk mund -- duke mos vënë re pra, që  
25 ishte pushka e gjahut.



1 PË. Arsyëja është se nuk e shihja dot, apo nuk e vija dot re  
2 sepse askush nuk më pyeti çfarë ka në rimorkio. Askush nuk më  
3 pyeti apo të më thoshte në ndonjë moment se çfarë kishte  
4 rimorkio e plugut edhe pse unë thashë që e pashë pushkën, me  
5 të na ndaluar dhe kur e kontrolluan rimorkion i konfiskuan  
6 armët që ishin në rimorkio. Por nuk mund ta përmendja këtë  
7 kuti sepse askush nuk më bëri pyetje për të.

8 PY. Dëshmitar, arsyëja se pse po e thoni këtë gjë sot është  
9 sepse në fakt ju nuk jeni treguar i vërtetë në dëshminë tuaj,  
10 apo jo?

11 PË. Jo, kështu mendoni ju që unë nuk kam treguar të vërtetën  
12 por unë mendoj që jam tërësisht i vërtetë dhe kam treguar  
13 gjithçka që dija në lidhje me këtë çështje.

14 Z. TULLY: [Përkthim] Këto ishin pyetjet e mia, të nderuar.

15 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Baiesu.

16 Pyetje të palës tjetër nga z. Baiesu:

17 Z. BAIESU: [Përkthim]

18 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Unë jam përfaqësuesi i z. Jakup  
19 Krasniqi dhe kam disa pyetje për ju.

20 Do të doja që të shikonit pjesën e intervistës së ZPS-së  
21 ku thoni që ju kanë çuar në Budakovë, pra në fshatin e  
22 Budakovës në korrik 1998. Në intervistën me Prokurorin keni  
23 përmendur një anëtar të UÇK-së që e keni njohur në Budakovë që  
24 e ka mbiemrin Krasniqi. A ju kujtohet ta keni thënë këtë,  
25 Dëshmitar?

1 PË. Po, e kam përmendur Krasniqin. Kam përmendur një burrë i  
2 cili ishte i veshur me rroba civile. Në qoftë se nuk gabohem  
3 kishte mjekër, ishte i shkurtër, ndoshta 1.65 dhe ishte dikush  
4 i cili ishte nga Suhareka. Nëse nuk gabohem ai kishte një  
5 dyqan, një shitore së bashku me një vëllanë e tij. Ose ndoshta  
6 me një të afërm të tij. Asnjëherë nuk kam thënë për këtë  
7 person që kishte veshur uniformë të UÇK-së ose që ishte ushtar  
8 UÇK-së.

9 PY. Ju i keni dhënë Prokurorisë përshkrimin që sapo dhatë.  
10 Pra, që kishte flokë të shkurtra të zeza dhe kishte mjekër të  
11 madhe, kështu?

12 PË. Po.

13 PY. Gjithashtu keni përmendur me Prokurorinë pra, me  
14 intervistën e dhënë Prokurorisë që ju e keni parë një person  
15 që quhet Jakup Krasniqi nga Reçani. A ju kujtohet kjo,  
16 Dëshmitar?

17 PË. Unë thashë që e njihja Jakupin që ishte fqinji i axhës,  
18 Stankoviq, por nuk kam thënë asnjëherë që mbiemrin e kishte  
19 Krasniqi. Me aq sa më kujtohet nuk e kam thënë asnjëherë një  
20 gjë të tillë.

21 PY. Ky person, Jakup Krasniqi, nuk ishte pjesëtar i UÇK-së,  
22 pra ky personi që ju thoni që e kishte emrin Jakup, por nuk e  
23 kujtoni si e kishte mbiemrin nuk ishte ushtar i UÇK-së, apo  
24 jo?

25 PË. Ai nuk kishte uniformë, nuk them dot asgjë tjetër sepse

1 atë person e njihja nga më përpara. Unë kam ndjekur shkollën,  
2 kam shkuar në shkollë në Suharekë dhe kam ndenjur para  
3 shitores së tij duke pritur për autobusin që të më çonte në  
4 shtëpi. Kështu e njihja. E njihja që nga përpara. Kështu e  
5 njihja që nga përpara.

6 PY. Pra, juve nuk ju kujtohet sesi e kishte mbiemrin, thjeshtë  
7 ju kujtohet si e kishte emrin, që quhej Jakup dhe që ishte nga  
8 Deçani [Sipas përkthimit], kështu?

9 PË. Po. E njihja personin ishte pak më i vjetër në atë kohë,  
10 ndoshta ishte rreth të 60-tave në atë kohë, çfarë do të thotë  
11 që ndoshta do të ishte 80 mbase edhe 90 vjeç tani. Ai ishte  
12 fqinji më i ngushtë i Stanko Stakoviqit dhe Stanko Stankoviqi  
13 është rrëmbyer së bashku me mua. Ata të dy kishin marrëdhënie  
14 shumë të mira me njëri-tjetrin.

15 Kur Prokurori më pyeti, unë i thashë që nuk e kisha  
16 dëgjuar asnjëherë emrin Jakup Krasniqi që është një prej të  
17 akuzuarve këtu. Nuk e kam dëgjuar asnjëherë emrin e tij  
18 përpara fillimit të këtij procesi gjyqësor në vitin 2020.

19 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Nuk kam pyetje të tjera për ju.

20 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetje  
21 plotësuese nga Prokuroria?

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Vetëm një pyetje kemi ne, i  
23 nderuar Gjykatës.

24 Pyetje të mëtejshme nga z. Michalczuk:

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

1 PY. Dëshmitar, në pyetjet që ju bëri Prokuroria - dhe për  
2 procesverbal i kemi në faqen 10978, në rreshtat 2 deri në 5,  
3 në dëshminë që keni dhënë në dhjetor, edhe gjithashtu edhe në  
4 përgjigje të kundërpyetjeve nga z. Kehoe - dhe për  
5 procesverbal këto pyetje dhe përgjigje i kemi në faqen 11008,  
6 rreshtat 24, 25, si dhe 11009 rreshtat 1 deri në 18 dhe sot në  
7 faqet 76, rreshtat, 11, 12, 24, 25 dhe në faqen 77, rreshti  
8 15, 16 i transkriptit të përkohshëm. Ju thatë që jeni rrahur  
9 së bashku me [REDAKTUAR] dhe së bashku me një person nga  
10 Reçani, dhe thatë që i keni parë që ata të jenë rrahur së  
11 bashku me juve dhe që keni dëgjuar zërat e piskamave të  
12 [REDAKTUAR]. Më pas në përgjigje të kundërpyetjeve si në dhjetor  
13 edhe sot, dhe për procesverbal faqen janë 11010, rreshtat 8  
14 deri në 21, dhe sot në transkriptin provizor 75 deri në 78,  
15 pra në faqen 76 deri në faqen 79 --

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nuk e di, të nderuar Gjykatës,  
17 nëse mund t'ju kërkoj që të kalojmë në seancë private. Ju  
18 kërkoj ndjesë që nuk jua kërkoja më herët këtë gjë.

19 [Seancë private]

20 [Seancë private teksti i fshirë]

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të mëtejshme nga z. Michalczuk

Faqe 117

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të mëtejshme nga z. Michalczuk

Faqe 118

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18 [Seancë e hapur]

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi  
20 në seancë publike.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja ime e parë ka të bëjë  
22 me uniformat, me personat që ju i njohët si pjesëtarë të UÇK-  
23 së, Sokol Kabashi, ose Shukri apo Shukrije Gashi, pra, çfarë  
24 uniformash kishin ato kur ju ndaluan juve dy kushërinjtë tuaj  
25 në afërsi të fshatit me datë 4 korrik 1999 - 1998, më falni.

1 A mund të na thoni se si dukeshin këto uniformat e këtyre  
2 dy personave. Domethënë, ishin me ngjyrë, a ishin të larme?  
3 Mund të na thoni? Na i përshkruani pak uniformat e këtyre dy  
4 personave.

5 PË. Uniformat e tyre ishin të zeza. Në fakt ishin si  
6 kominoshe. Pra, uniformat e tyre ishin kominoshe, ishin një  
7 trup pjesa e sipërme dhe e poshtme, ndoshta kështu përshkruhet  
8 më mirë.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po ndonjë beretë apo kapele a  
10 kishin a ju kujtohet?

11 PË. Nuk më kujtohet, më vjen keq. Nuk më kujtohet në qoftë se  
12 kishin ndonjë gjë të vënë në kokë. Kanë kaluar 25 vite që  
13 atëherë. Dhe ka pasur -- është shpërndarë kaq shumë  
14 informacion në YouTube, në mediat sociale, kështu që vërtetë  
15 nuk më kujtohet. Por, ajo çfarë më kujtohet me siguri janë  
16 uniformat e zeza.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull, pa problem. Po  
18 ndonjë shenjë të vënë te krahu, a ju kujtohet?

19 PË. E di që Shukri Gashi kishte një radio marrëse-dhënëse.  
20 Ndoshta ka pasur diçka në krahun e majtë, megjithatë nuk jam i  
21 sigurt, nuk më kujtohet. Megjithatë, ajo çfarë di me siguri  
22 ishte që kishte një radio, një pajisje radio.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nga e dini ju që këta  
24 ushtarët e tjerët që ishin aty kishin sinjale të UÇK-së, apo  
25 kishin emblemën e UÇK-së.



1 PË. Personat e tjetër që ishin aty ndoshta nja 15 veta pak a  
2 shumë asnjëri prej tyre nuk kishte uniforma. Domethënë,  
3 uniforma të larme, për shembull kur na dërguan në fshatin  
4 Budakovë në oborrin e familjes Alushi [Sipas përkthimit]  
5 kishte shumë burra me uniformë atje, pjesa -- disa prej të  
6 cilave kishin veshur uniforma të larme, disa të tjerë kishin  
7 bereta të kuqe, disa kishin emblema në krah, disa të tjerë  
8 kishin në shpatull emblemë. Megjithatë, unë po flas domethënë  
9 për këto uniformat e larme dhe emblemat.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nga e dini ju që Sokol  
11 Kabashi dhe Shukri Gashi ishin me UÇK-në ishin pjesëtarë të  
12 UÇK-së në atë kohë?

13 PË. Kur e pyeta "Komshi çfarë po ndodh?", ai më tha "Nuk di  
14 asgjë. Komandanti do të vendosë se çfarë do të bëjë me juve.".   
15 Sepse tre ditë përpara sesa të ndodhte kjo unë e kisha takuar  
16 Shukri Gashin në fshat.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe ju e dinit që ai ishte  
18 pjesëtar i UÇK-së, këtë po thoni? Apo nuk e dinit?

19 PË. Nuk e dija. Mendoja që kjo do të përkonte me faktet ose  
20 mblodha faktet me njëri-tjetrin, por nuk e dija në qoftë se ai  
21 faktikisht ishte ushtar i UÇK-së apo jo. Nuk mund ta them me  
22 siguri këtë, jo.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja e radhës ka të bëjë me  
24 rrahjet që keni pësuar kur ju jeni burgosur më vonë sipas  
25 dëshmisë tuaj. Atëherë, sipas dëshmisë me ZPS-në me 4 shtator

1 2020, është prova materiale P756.2, faqja 7, rreshtat 9 deri  
2 në 12, ju thatë që individët që ju rrahën ishin me uniformë  
3 edhe kishte edhe gra ose vajza ndërmjet tyre.

4 A mund të na përshkruani ju lutem, na shpjegoni pak nëse  
5 mundeni se çfarë lloj uniformash kishin veshur njerëzit që ju  
6 rrahën ju, ose më konkretisht çfarë ngjyre kishin uniformat që  
7 kishin veshur këta njerëz.

8 PË. Ishin kryesisht uniforma me lara.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Uniformat e personave që ju  
10 rrahën a kishin emblema, në qoftë se ju kujtohet?

11 PË. Nuk mund ta them me siguri sepse nuk kam pasur aq kohë që  
12 të shquaja, që të shikoja çdo detaj, çdo hollësi të mundshme.  
13 Kishte ndonjë çast ku ajo pjesa që më kishin mbyllur sytë mund  
14 të më binte poshtë dhe kisha mundësi që mund të shikoja ndonjë  
15 gjë të vogël, por pastaj e mbuloja prapë fytyrën dhe sytë në  
16 mënyrë të tillë që të mos më gjuanin më.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju kujtohet që i keni thënë  
18 ZPS-së që ju kanë rrahur edhe gratë ose vajzat? Dhe pyetja ime  
19 është a ishin të veshura me uniformë ato gratë ose vajzat dhe  
20 në qoftë se po, çfarë pamje kishin këto uniformat? Si ishin  
21 këto uniforma?

22 PË. Nuk më kujtohet në qoftë se ishin dy apo tre vajza me  
23 flokë të gjata me uniforma të larme. Nuk mund të them që  
24 asnjëra prej tyre nuk më ka goditur. Nuk më kujtohet  
25 ekzaktësisht. Megjithatë, më kujtohet që kam parë dy apo tre

1 vajza të veshura me uniforma me lara.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshmitar, në dhjetor në  
3 kundërpjetet nga Mbrojtja e z. Thaçi juve ju u pyetët sa më  
4 poshtë, dhe duhet këtu t'i referohem transkriptit në faqen  
5 109996, pra rreshtat 1 deri në 9:

6 "PY. Ju u takuat me Bajram Morinën, ai ju tregon rrugën  
7 dhe ju jeni thujse dy burra 19 vjeçarë në moshë lufte, kur të  
8 mundeni ju filloni që të vraponi".

9 Dhe pastaj vazhdohet më tej më tej me transkriptin:

10 "Sepse ne e kuptuam që ishim në rrezik sepse përpara këtij  
11 incidenti kishte pasur disa raste kidnapimesh. Kishte pasur  
12 disa të afërm nga Reçani të cilët ishin kidnapuar. Duke  
13 menduar këtë gjë ne e kuptuam që ishim në rrezik dhe duhej që  
14 të largoheshim."

15 A ju kujtohet ta keni thënë këtë gjë herën tjetër që ishit  
16 këtu?

17 PË. Po.

18 PY. Trupi Gjykses dëshiron të dijë se kush ishin këta të  
19 afërmit tuaj ose kushërinjtë tuaj që ishin kidnapuar nga  
20 Reçani?

21 PË. Ishte Mija dhe Milovan Krastiq [Sipas përkthimit] që ishin  
22 vëllezër dhe Bobani që ishte kushëriri i tyre. Nuk e di se  
23 çfarë lidhje gjaku kishin saktësisht, por të gjithë ata të tre  
24 ishin nga Reçani.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ishin këta personat që këta

1 pjesëtarët e UÇK-së që ju thanë që do ju çonin te këta persona  
2 përpara sesa të fillonin e të rrihnin, siç na thatë herën e  
3 mëparshme që keni qenë këtu?

4 PË. Jo. Mendoj që mund ta gjeni këtë edhe në deklaratën time  
5 ku time, ku përmendet dhe thuhet se njëri prej ushtarëve na  
6 tha që do të na çonte te liqeni për të ushqyer peshqit me neve  
7 sepse këta komshinjtë e mi, Milovani, Bobani ishin atje. Kam  
8 përshtypjen që e kam thënë këtë në deklaratën time, nëse  
9 s'gabohem.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kjo në fakt do të ishte  
11 pyetja ime tjetër. A mund të na thoni, diçka plus se çfarë  
12 ndodhi me kushërinjtë tuaj, Milani, Bobani dhe personi tjetër,  
13 Krstiq. Domethënë, me fjalë të tjera kanë vdekur këta persona  
14 apo jetojnë ende edhe sot e kësaj dite?

15 PË. Nëse do të shohim marrëdhëniet unë kam shumë kushërinj të  
16 tjerë të cilët janë zhdukur. Për disa prej tyre janë  
17 zhvarrosur eshtrat e tyre, si për shembull, eshtrat e 14  
18 anëtarëve e një familjes në Kostiq -- familjes Kostiq nga  
19 Retimja, nga fshati Retimë, ose në Opterushë. Ndërkohë që ka  
20 edhe shumë të tjerë për të cilët edhe sot e kësaj dite nuk e  
21 dimë se ku prehen.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Besoj se na thanë  
23 gjatë diskutimit ose gjatë dëshmisë tuaj vitin e shkuar që  
24 juve mjeku që ju ka vizuar pas ngjarjes në fjalë ju ka thënë  
25 që gjashtë nga brinjët tuaja kanë qenë të thyera. Këtë e

1 diskutuat gjithashtu me z. Kehoe nga Mbrojtja e z. Thaçi.

2 A është e saktë kjo, a ju ka thënë mjeku që gjashtë brinjë  
3 tuajat janë thyer në atë rast kur jeni vizituar nga mjeku?

4 PË. Po, këtë më tha ai kur më vizitoi, mua dhe Krsta Jeftiqin.

5 Na vizitoi në të njëjtin vend, në të njëjtin apartament.

6 Fatkeqësisht, e them edhe një herë tjetër që ai tani nuk jeton  
7 më. Ka vdekur në vitin 1999. Ka shumë veta që kanë vdekur ose  
8 janë vrarë, kështu që shumë vonë për të bërë diskutime dhe për  
9 prova të kësaj natyre sepse -- më vjen keq sepse do të kishte  
10 pasur shumë gjëra të cilat do të mund të provoheshin po të  
11 kishte qenë ndryshe. Kjo është diçka që ka ndodhur midis  
12 shqiptarëve dhe midis serbëve në të gjithë situatën.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk është problem. Unë  
14 thjeshtë po ju pyes se çfarë lloj lëndimesh keni pësuar juve.  
15 Po lëndime të tjera keni pësuar ju vetë?

16 PË. Me përjashtim të disa çjerrjeve, shenjave që kam pasur në  
17 krahun tim, apo shenjave të zeza, asgjë tjetër. Asgjë tjetër.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po sot e kësaj dite a keni  
19 probleme, qofshin ato fizike ose mendore që ju e lidhni me  
20 burgimin ose keqtrajtimin tuaj në verën e vitit 1998?

21 PË. Ndonjëherë ka çaste. Ka momente. Veçanërisht kur flitet  
22 për luftën, për gratë, për fëmijët, për vrasjet. Kjo më prek  
23 kryesisht. Përndryshe, jo.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Së fundi, Dëshmitar, e jeni  
25 kthyer ndonjëherë në fshatin tuaj në Kosovë pas ngjarjeve të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga Trupi Gjykues

Faqe 126

1 këtij rasti që diskutuam dhe në qoftë se jo, ju lutem, na  
2 thoni pse nuk jeni kthyer?  
3 PË. Jo, nuk jam kthyer më kurrë atje. Më kanë thënë që jam  
4 pjesë e një lloj liste sekrete dhe në qoftë se unë përpiqem që  
5 të kaloj kufirin do të arrestohem, megjithatë nuk e di arsyen  
6 se pse. Dhe sigurisht që nuk kam asnjë lloj shpjegimi lidhur  
7 me këtë.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po Krsto Jeftiq, kushëriri  
9 juaj a është kthyer ndonjë herë në Kosovë mbasi ju të dy  
10 shkuat në Beograd?

11 PË. Jo, askush nga ne të dy. Ne të dy jemi larguar me 17 mars  
12 1999. Dhe i vend i sigurt ku mund të shkonim ishte ushtria.  
13 Kështu që kemi shkuar në ushtri me 17 mars. Fatkeqësisht,  
14 agresioni NATO është datë 24, pra siç e dinë të gjithë filloi  
15 agresioni i NATO-s mbi Serbinë. Kështu që për gjashtë ose tetë  
16 muaj të tjerë nuk kemi pasur më kontakt, as me familjet tona  
17 dhe as me njëri-tjetrin.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar. Nuk  
19 kam pyetje të tjera për ju.

20 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
21 Mettraux.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi  
23 Smith.

24 Mirëdita, Dëshmitar. Dëshiroj t'ju kërkoj disa sqarime. Së  
25 pari, dua t'ju pyes në sa vende, në sa lokacione në Budakovë

1 jeni burgosur, në një vend apo në më tepër sesa një vend?

2 PË. Nëse flasim për burgosjen ose ndalimin, ne kemi qenë të  
3 mbajtur, të ndaluar në qilarin e familjes Kokollarit, Jahir  
4 Kokollarit. Por nga ana tjetër në qoftë se do të numërojmë  
5 edhe shtëpinë Palushi dhe marrjen në pyetje në bunker në  
6 oborrin e fshatit, kjo është tjetër gjë. Por, në qoftë se nuk  
7 i marrim parasysh këto atëherë do të thotë që vetëm në një  
8 vend jemi mbajtur.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe sa i madh ishte ky  
10 vendi në Budakovë, në qoftë se do të mund të na jepni ndonjë  
11 ide? Ça sipërfaqe ishte ky vendi në Budakovë ku jeni mbajtur i  
12 ndaluar?

13 PË. Fshati është i ndarë në mëhalla, në lagje. Është goxha i  
14 shtrirë. Nuk e di sesi t'ja u them. Pra, Budakova, fshatrat  
15 përreth janë të gjithë të ndërlidhur, pastaj është mëllaha  
16 Hoxhë që shtrihet më tej drejt Bukoshit, drejt fshatrave të  
17 tjerë, kështu që është e vështirë për mua që t'ju jap shifra  
18 konkrete apo që t'ju them konkretisht se për çfarë fshati  
19 bëhet fjalë. Megjithatë, duke pasur parasysh numrin e banorëve  
20 do të thoja që është një fshat mesatar në madhësi.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A jeni në dijeni sesa larg  
22 këtij fshati gjendesh Shtabi i Përgjithshëm, në qoftë se e  
23 dini, kuptohet?

24 PË. Në qoftë se marrim parasysh që vendi ku na morën, na  
25 dërguan, ishte shtabi i tyre, ku na lidhën duart edhe sytë, ky

1 vendi është në qendër të Budakovës aty ku ka qenë stacioni i  
2 autobusit. Tani në qoftë se ka pasur ndonjë vend tjetër ku  
3 gjendej shtabi këtë nuk mund t'ja u them, nuk e kam  
4 informacionin. Unë personalisht e konsideroj vendin ku na  
5 dërguan si shtabin e tyre. Po a ka qenë vërtetë shtab apo jo,  
6 apo në qoftë se ka ndodhur ndonjë gjë tjetër më vonë, këtë nuk  
7 ja u them dot.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa larg ka qenë ky vendi  
9 tek stacioni i autobusëve nga njëri vend ose nga dy vendet ku  
10 ju keni qenë të ndaluar? Në qoftë se mund të na e thoni, kanë  
11 qenë gjysëm ore, ka qenë më shumë, ka qenë më pak?

12 PË. Duke gjykuar nga koha që na morën për të shkuar me makinë,  
13 besoj që ka qenë nga një në dy kilometra. Ndoshta dy  
14 kilometra. Megjithatë është e vështirë për mua për t'ja u  
15 thënë me saktësi, por jo shumë larg do të thoja.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e drejtë të thuhet  
17 se gjatë të gjithë kohës së ngjarjeve që na treguat ju keni  
18 qenë nën ruajtjen e pjesëtarëve të UÇK-së, kështu ka qenë apo  
19 jo?

20 PË. Po, po. Po pa diskutim. Askush tjetër nuk mund të bënte  
21 roje aty përveç atyre, nuk mund të kishte qenë askush tjetër  
22 përveç këtyre. Rojet që bënë roje atje siç e thashë edhe ca  
23 kohë më përpara unë -- njëri rojeve më dha një cigare. Do të  
24 kisha dashur t'ja dija emrin për ta falënderuar sepse në  
25 momente të tilla edhe diçka e vogël, një gjest i tillë i vogël



1 ka shumë domethënie.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju na thatë që në një fazë  
3 të caktuar një fqinj i juaj erdhi për t'ju liruar. Kështu apo  
4 jo?

5 PË. Po, dy mësues. Njëri prej tyre ishte vëllai i Shukri  
6 Agashit [Sipas përkthimit]. Shukri Agashi [Sipas përkthimit]  
7 që më kidnapoi mua, Fadil Gashi. Fatkeqësisht, ai vdiq  
8 ndërkohë dhe pastaj ishte Jetish Gashi ose Tabashi [Sipas  
9 përkthimit], që ishte komshiu ngjitur me Krista Jefçin [Sipas  
10 përkthimit]. Të dy këta erdhën për t'ju kërkuar këtyre të  
11 tjerëve që të na linin ne të largoheshim se ne ishim të  
12 pafajshëm dhe na kishin rrëmbyer. Dhe ata na thanë që "Më mirë  
13 ose kthehuni ose përndryshe do të përfundoni aty ku janë ata  
14 të tjerët".

15 Ndërkohë, më vonë kam mësuar që edhe fqinjë të tjetër janë  
16 përpjekur të që ndërhyjnë në mënyrë të tillë që ne të  
17 liroheshim prej tyre. Unë besoj se kjo ka qenë e dobishme.  
18 Besoj se falë ndërhyrjes së tyre ne në fund pas 24 orësh u  
19 lëruam. Ka pasur edhe një rast të babait të Kristasit [Sipas  
20 përkthimit] dhe Isak Berisha që shkonte në Shqipëri dhe u  
21 vinte patkonj kuajve që ishin shokë shumë të mirë, shumë të  
22 ngushtë, domethënë, dhe takohej me këtë burrin shpesh edhe e  
23 pyeste sesi ishte me shëndet.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini se nga e kishin  
25 marrë vesh komshinjtë tuaj se ishit ndaluar ju dhe erdhën për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 130

1 t'ju gjetur juve? U mor vesh gjerësisht aty në zonë, në rajon  
2 që juve ju arrestuan dhe e dinin gjerësisht njerëzit se ku  
3 ishit ju?

4 PË. Po, sigurisht.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju thatë që Shukri Gashi ju  
6 tha që fati yt, fati juaj do të vendosej nga dikush që ai e  
7 quajti "komandanti". A e keni idenë se për kë e kishte fjalën  
8 ai kur e tha këtë gjë?

9 PË. Jo, nuk e di. Nuk e di për kë e kishte fjalën. Ndoshta  
10 ishte thjeshtë arsye. Ndoshta thjeshtë e tha sa për të kaluar  
11 kohën "komandantin". Ai është personi që e di më mirë se çfarë  
12 donte të thoshte kur e tha atë fjali që "do të vendosë  
13 komandanti". Se askush nuk e dinte se kush isha unë. Unë vetë  
14 nuk kisha dëgjuar për askënd. Nuk kisha dëgjuar, për shembull,  
15 as për Hashim Thaçin as për Kadri Veselin edhe as ata nuk mund  
16 ta dinin se ku isha unë, të paktën deri në momentin kur jam  
17 rrëmbyer. Ndërkohë Shukri Gashi më njihte mirë se ishim  
18 komshinj, ishim rritur me njëri-tjetrin.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit për  
20 përgjigjet. Nuk kam pyetje të tjera.

21 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë  
22 pyetje nga Prokuroria mbështetur në pyetjet e bërë nga  
23 Gjykatësit?

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje.

25 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Po.

2 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Kehoe:

3 Z. KEHOE: [Përkthim]

4 PY. Kam disa pyetje për ju, Dëshmitar.

5 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
6 çaktivizuar] Sa mendoni, sa kohë ju duhet, pesë minuta, dhjetë  
7 minuta? Sa mendoni? Në rregull vazhdoni.

8 Z. KEHOE: [Përkthim]

9 PY. Duke iu përgjigjur pyetjeve të Gjykatës Bark [Sipas  
10 përkthimit] u përgjigjët dhe thatë që i kishit thënë  
11 Prokurorit që dikush ju kishte thënë që do t'ju çonin te  
12 liqeni. Unë po ju them që në deklaratën që i keni dhënë  
13 Prokurorisë nuk përmendet askush që dikush do të çojë dikë te  
14 liqeni. Asgjë.

15 PË. Nuk e di cilën deklaratë keni parë, por mendoj që është e  
16 shënuar në deklaratë, ashtu si e kuptoj [E pakuptueshme].

17 PY. Në këtë deklaratë që keni dhënë ju, a keni thënë që jeni  
18 kërcënuar se do t'ju çonte dikush te liqeni?

19 PË. Mendoj se po.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Është Pjesa 1 e deklaratës së  
21 dhënë Prokurorisë. Pra, Avokati po gabohet tek pjesa e  
22 deklaratës.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju flisni për liqen aty.

24 PY. Vazhdojmë më tej. Përgjigja jua Gjykatësit Barthe tha që  
25 nuk keni shkuar në shtëpi pas liritimit. Në fakt keni shkuar në

1 shtëpi, tek fqinjët apo jo, pas liritimit?

2 PË. Nuk është shënuar askund që kam thënë që kam thënë që jam  
3 kthyer në shtëpi? A mund të më thoni ku thuhet, në cilën  
4 deklaratë është kjo?

5 PY. Përgjigjuni pyetjes, ju lutem. Pas liritimit jeni kthyer në  
6 fshatin tuaj apo jo?

7 PË. Jo, kemi shkuar në fshatin Leçan [Sipas përkthimit], jemi  
8 kthyer te shtëpia e Stanko Stanković nga ku kishim ardhur.

9 PY. Pra, keni shkuar në Leçan -- Reçan apo keni ndejtur në atë  
10 zonë -- kur u thirrët për t'ju bashkuar ushtrisë për t'u bërë  
11 ushtar pra në ushtrinë serbe?

12 PË. Kjo ka ndodhur me 17 mars 1999. Pra vitin më pas.

13 PY. Pas fillimit të bombardimeve të NATO-s dhe vazhdimit të  
14 luftës vetëm pas kësaj, këtij momenti nuk jeni kthyer më në  
15 fshatin tuaj, a është kështu?

16 PË. Jo, nuk jam kthyer në fshat që nga momenti i rrëmbimit.

17 PY. Thatë që jeni kthyer në Reçan, në shtëpinë në fshatin e  
18 Stanko Stankovićit, apo jo?

19 PË. Po kjo s'është shtëpia ime, dhe unë nuk jam kthyer në  
20 fshatin tim.

21 PY. Jeni kthyer në Reçan pasi jeni liruar me Stanko  
22 Stankovićin.

23 PË. Po. Dhe po të njëjtën ditë jemi transportuar në Suharekë.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Në qoftë se mund më jepni dy minuta  
25 z. Gjykatës.

1 Prokurori të shfaqti në ekran dokumentin 025430 në 435. Të  
2 kalojmë tek faqja e Prokurorit, paragrafi 8.3

3 PY. E lexuat -- të kanë lexuar -- t'u lexua paragrafi pra nga  
4 Prokurori, paragrafi 8.3 ku flitet për rrahjen e [REDAKTUAR]  
5 [REDAKTUAR] [Sipas përkthimit], ju nuk thoni që e keni parë këtë  
6 gjë.

7 PY. Çfarë doni të thoni që nuk e kam parë, ndërkohë që ishim  
8 në të njëjtën gjendje, në të situatë në atë kohë?

9 Në këtë paragraf - pyetje - a thuhet që e keni parë apo  
10 jo. Po ose jo?

11 PË. A mund ta përsërisni pyetjen ju lutem?

12 PY. Po e tërheq pyetjen dhe po kaloj te paragrafi 8.4. në  
13 qoftë se tre rreshta më poshtë, aty më lejoni ta lexoj:

14 "Dejani foli me njërin prej të atyre të UÇK-së që po e  
15 ruante dhe roja ishte nga Drenica. Roja erdhi në podrum, u  
16 kthye në orën 5.30 pas -- paradite edhe mori Dejanin, Kriston  
17 dhe Santën [Sipas përkthimit] dhe i vendosi ata në makinë me  
18 të cilën kishin ardhur. [REDAKTUAR] ishte akoma aty në podrum kur  
19 ata u larguan..."

20 PË. Jo, [REDAKTUAR] e kanë marrë më parë, më herët. Kjo është hera  
21 e pestë që po ju përgjigjem të njëjtës pyetje, z. Kehoe. Me  
22 datën 5 në mëngjes të dy, [REDAKTUAR] dhe ai djali i ri  
23 nga Reçani u larguan, u hoqën na podrumi.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Z. Gjykatës, mendoj që duhet të  
25 kalojmë në seancë private për këtë sepse ka emra.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 134

1 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në  
2 seancë private.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Dejan Jeftic (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 135

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9 [Seancë e hapur]

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi  
11 në seancë publike.

12 GJYKATËSI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se  
13 nuk ka diçka tjetër mbyllim seancën këtu deri të hënën në orën  
14 9 të mëngjesit.

15 --- Seanca mbyllet në orën 16.12

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25